

**STATUTI**  
**I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUARA**  
**“PHOENIX GROUP LIMITED” shpk**

Në këtë statut

- “Ligji” është Ligji Nr. 9901, dt. 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë tregtare”;
- “Statuti” është Statuti i shoqërisë;

**KREU I**

**Themelimi, Emri, Objekti, Kohëzgjatja dhe Selia e shoqërisë**

**Neni 1**

**Data e themelimit, Emri dhe Themeluesi**

Shoqëria “PHOENIX GROUP LIMITED” shpk themelohet në Tiranë me datë 01.10.2020 nga themeluesi:

**Ervis Myftari**, i biri i Sadushit, i datëlindjes 08/05/1979, lindur dhe banues në Tiranë në adresën Rruga “Pjeter Bogdani, P.20/4”, madhor dhe me zotësi të plotë për të vepruar, mbajtës i letërnjoftimit me Nr. Personal H90508052H.

**Neni 2**

**Organizimi**

Shoqëria “PHOENIX GROUP LIMITED” shpk, do të organizohet në formën e një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar.

**Neni 3**

**Kohëzgjatja**

Shoqëria “PHOENIX GROUP LIMITED” shpk është krijuar për të ushtruar veprimtarinë e saj për një afat të pacaktuar kohe.

Veprimtaria e shoqërisë fillon nga data e regjistrimit të saj në regjistrin tregtar dhe kjo veprimtari do të vazhdojë të ushtrohet në përputhje me legjislacionin në fuqi, dhe çdo ndryshim që do të bëjë shoqëria do të reflektohet në aktet e shoqërisë.

**Neni 4**

**Selia**

Selia e shoqërisë është në adresën Rr. “Ullishta, ZK.3266, Nr.Pasurie 96/64, VOL.20, Tirane”.



Shoqëria mund të zhvillojë aktivitetin e saj brenda dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë nëpërmjet hapjes së degëve dhe zyrave të përfaqësimit. Hapja e degëve dhe zyrave të përfaqësimit bëhet sipas parashikimeve të nenit 9 të Ligjit Nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare".

## **Neni 5** **Objekti i veprimtarisë**

Shoqëria "PHOENIX GROUP LIMITED" shpk do të ketë si objekt të veprimtarisë së saj:

Ndertime civile të të gjitha kategorive. Sistem shitjeje elektronik dhe transaksione financiare elektronike. Shoqëria kryen çdo lloj aktiviteti që ben pjese ne objektin e saj, që lidhet me të dhe që e mbështet atë. Shoqëria ka të drejtë të hapi dhe operojë: Agjenci për prerjen e siguracioneve të makinave dhe produkteve të agjencive të sigurimeve. Agjenci " Imobiliare " kontrata shit-blerje pronash, qera, leasing, huapërdorje, emfiteoze, kontrata kalimi të drejtash, kontrata heqje dore Aluizni, kontrata premtim shitje, etj, të pronave. Të marr dhe të japë hua si dhe të marre dhe të vendose kolaterale nga: shoqëri, institucione financiare, banka, fondacione, individë, brenda dhe jashtë vendit. Investime financiare të lejueshme nga ligji dhe të gjitha llojet e veprimtarive të real- estate Agjenci imobiliare, ndërmjetesim & marketing në fushën e sigurimeve. Ndermjetesim financiar, operacione me pasuri të paluajtshme , të luajtshme , tregtare , përfshirë dhenien e garancive, dorezanie, pengje , hipoteka. Shoqëria mund të kryejë edhe çdo veprimtari tjetër e cila është në ndihmë dhe e lidhur me objektin kryesor të veprimtarisë së saj.

Shoqëria mund të kryejë edhe çdo aktivitet të parashikuar nga Legjislacioni Shqiptar.

Shoqëria ka për objekt të veprimtarisë së saj dhenien me qira të makinave, motorëve, minibus, autobus, jahte, mjete lundruese etj, si dhe të gjitha llojeve të tjera të mjeteve motorike, personave të tretë. Tregtim, shërbim me qera, me drejtues mjeti, për çdo mjet të lëvizshëm të lejuar për qarkullim, shërbim taksit, shërbim urban, nderurban, nderkombëtar, nderkontinental, etj.

Shoqëria ka të drejtë të hapi dhe operojë Agjenci për prerjen e siguracioneve të makinave dhe produkteve të agjencive të sigurimeve. Transport udhëtarësh e mallrash, kombëtar e ndërkombëtar, cargo etj. Kryerjen e shërbimeve, servisit etj, për riparimin e mjeteve motorike të të gjitha markave të shitura ose jo prej Shoqërisë.

Shoqëria mund të zhvillojë aktivitetin e saj në fushën e publikimeve dhe reklamimit. Shitje me shumicë dhe me pakicë përmes internetit, prodhim, import dhe tregtim të kompjuterave, programeve dhe pajisjeve kompjuterike. Mirëmbajtje dhe përmirësim infrastrukture kompjuterike dhe rrjetesh kompjuterike.



Shoqëria mund të zhvillojë aktivitetin e saj në drejtim të zhvillimit të dekorit në mjedise urbane dhe punime restaurimi. Hapjen e qendrave dhe komplekseve sportive për argëtimin dhe çlodhjen e njerëzve, salla lojrash, salla për ushtrimin e forcës për femije dhe të rritur. Hapjen e qendrave estetike masazheve, kozmetike etj.

Shoqëria ka për objekt të veprimtarisë së saj hapje dhe operim të Agjencive Turistike, organizimi i guidave turistike Brenda dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë. Agjenci transporti ndërkombëtare udhëtarësh. Shitje dhe blerje automjesh.

Import-eksport të mallrave elektroshtepiake Projektim, instalim i sistemeve, rrjeteve e paisjeve fundore të telekomunikacionit, programimi e instalimi i sistemeve të radiokomunikacionit, ndërtime rrugore të kategorisë së parë, dytë, tretë, katërt e të pestë, ndërtime hekurudhore, detare, portuale, drenime, hidraulike, hidroteknike, restaurime, punime në prodhim e shpërndarje të energjisë, punime shërbimi, topogjeodezike, rëlevimetopografike, speciale gjeodezike, elektrike etj. Në fushën e programimit të Software dhe Platformave Software-ike, shërbime, riparime dhe mirëmbajtje të Software dhe Platformave Software-ike.

Ndërtime civile të të gjitha kategorive. Tregtim të artikujve të ndryshëm Import-Export, pajisje elektrike dhe elektronike, elektro- shtepiake, ushqimore, bujqësore dhe blektorale, veshmbathje, industriale, lende të para për industrinë, materiale ndërtimi materialeve inerte, prodhim elemente betoni e betonarme, konsulence në fushën e menaxhimit të investimeve dhe zbatim projektesh. Servis pajisje elektronike dhe elektroshtepiake. Shpërndarje dhe shitje të produkteve të telekomunikacionit. Transport të mallrave dhe të udhëtarëve urban, nderurban dhe ndërkombëtar. Spedicion të mallrave të import-eksportit, tranzite në territorin e Republikës së Shqipërisë. Sistem shitjeje elektronik dhe transaksione financiare elektronike. Shoqëria, përveç sa më sipër, mund të shesë, të blejë dhe të marrë pjesë në formën e aksioneve ose jo edhe në të tjera shoqëri vendase ose të huaja, të cilat kanë objekt të njëjtit veprimtari ose të ngjashme me të. Operacionet blerjesh dhe shitjesh mbi pasuritë e luajtshme dhe të paluajtshme. Tregtimin e të gjithë artikujve të mesipër me shumicë e pakicë, për llogari të vetë shoqërisë si dhe për llogari të të tjerëve. Administrim dhe konsulence në fushën e hotelierisë, të restoranteve dhe bareve, përfshirë këtu edhe hapjen e tyre në të gjithë territorin e Shqipërisë.

Konsulence në fushën juridike, tregtare dhe financiare. Të ushtroje veprimtari tjetër të lejuar nga ligji dhe/ose pjesëmarrjen në çdo veprimtari apo aktivitet të ligjshëm që mund të kryejë një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e krijuar në bazë të legjislacionit shqiptar. Të marrë pjesë në tendera publike ose private, kombëtare dhe ndërkombëtare në fushën e ndërtimit, infrastrukturave, të energjisë dhe në fusha të tjera vetëm ose në bashkëpunim e ortakëri të perkohshme me shoqëri të tjera. Të themelojë partneritete për kryerjen e punimeve me rëndësi strategjike brenda dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë edhe në fushën e ndërtimit dhe shfrytëzimit të distributoreve të karburanteve.

Të kryejë veprimtari tregtare, industriale, financiare, imobilare e hipotekore në përputhje me statutin dhe objektin e saj dhe hidro-sanitare, pajisje zyresh dhe kancelari, pjesë kembimi auto e



makineri te cdo lloji, pajisje teknologjike, vajra lubrifikante, etj, si dhe tregtimi i tyre brenda dhe jashte vendit, me shumic e pakic. Ne fushen e projekteve te ndertimeve civile, industriale, turistike, prodhimin e shoqeror; Te marre pjese me aksione edhe ne shoqeri te tjera vendase, te huaja ose me kapital te perbashket qe kane object shoqeror dhe aktivitet te ngjashem me te.

Te krijoje filiale dhe zyra perfaqesie ne qytete te tjera te Shqiperise ose ne shtete te tjera, ne perputhje me legjislacionin e tyre. Te kryeje cdo aktivitet tregtar, financiar, dhenie-marrje me qera, te vendose pengje dhe barre hipotekore; aktivite keto te konsideruara si te dobishme apo te nevojshme per te arritur qellimet e Shoqerise dhe qe nuk tejkalojne ne mase aktivitetet kryesore, te cituara me siper; Te kryeje aktivite publikimi dhe reklamimi. Shoqeria zhvillon aktivitetin e saj ne fushen e biznesit "Duty Free on Board", (aktivitet qe zhvillohet nepermjet magazines doganore per produktet qe do te tregtohen ne bordin e avioneve dhe te anijeve te ndryshme), nepermjet importit dhe eksportit te mallrave qe tregtohen ne kete fushe sipas legjislacionit shqiptar ne fuqi. Shoqeria kryen instalime te sistemeve te matjes dhe sistemeve fiskale ne pikat e magazinave te lira doganore dhe pikat e shumices se gazit te lengshem. Shoqeria mund te veproje si subjekt jobanke ne ofrimin e sherbimit te pagesave dhe te arketimeve nga dhe per te tretet. Shoqeria kryen trajnime afatshkurtra profesionale mbi fushat ku kjo shoqeri operon.

Shoqeria kryen studime dhe analiza ne fushen e energjise ne pergjithesi. Projektim i te gjitha llojeve te veprave energjitike, ndertimi i hidrocentraleve te te gjitha llojeve dhe impjanteve te ndryshme energjitike. Ndertimi i linjave te tensionit e interkoneksionit te te gjitha niveleve te tensionit. Menaxhimi dhe operimi i veprave te ndryshme energjitike. Operimi optimal tekniko ekonomik i hidrocentraleve, termocentrale dhe llojeve te tjera te impjanteve te eres, termale, gjeotei male e solare per prodhimin e energjise elektrike. Shitja e energjise elektrike klienteve dhe operatoreve te ndryshem private apo shteterore brenda e jashte e jashte vendit.

Transmetimin dhe shitjen e energjise elektrike ose interkonjeksionin nderkombetar. Perdorimin e sistemeve te linjave strukturave mbeshtetese dhe pajisjesh transformuese e kontrolluese per transmetimin e energjise elektrike. Shperndarjen, transporti e energjise elektrike ne sistemet shperndarese te tensionit te mesem dhe te ulet deri tek konsumatori i fundit. Eksport - import dhe tranzitim i energjise elektrike.

Shoqeria shet ose jep me qera pajisje per zyra, motele, hotele, mobileri, kabina, dhe objekte druri, pajisje per bare, restorante dhe dyqane, etj.

Shoqeria kryen cdo lloj aktiviteti qe bej pjese ne objektin e saj, qe lidhet me te dhe qe e mbeshtet ate.



## KREU II KAPITALI

### Neni 6 Kapitali themeltar

Kapitali i regjistruar i shoqërisë është 100 (njëqind) lekë. Pjesëmarja e ortakut themelues në kapitalin e shoqërisë është si më poshtë:

**Ortaku themelues Ervis Myftari**, zotërues i 1 (nje) kuote me vlerë 100 (njëqind) lekë, i cili zotëron 100 % të kapitalit themeltar të shoqërisë;

### Neni 7 Llojet e Kuotave, të Drejtave dhe Kufizimeve

Në përputhje me dispozitat e Ligjit dhe pa cënuar të drejtat që rrjedhin nga kuotat ekzistuese, kuotat mund të emetohen me të drejtat ose kufizimet e parashikuara në vendimin e Asamblesë së Përgjithshme, e cila merr vendime ne përputhje me nenin 81, pika 3 e Ligjit Nr. 9901, date 14.04.2008.

### Neni 8 Çertifikatat e kuotave

Ortaku ka të drejtë të përfitojë një çertifikatë për kuotat e zotëruara prej tyre, të cilat lëshohen nga ana e shoqërisë. Çertifikata nuk do të gëzojë cilësinë e letrës me vlerë.

### Neni 9 Mënyrat e fitimit dhe kalimit të kuotave

Kuotat e kapitalit të shoqërisë dhe të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:

- a) kontributit në kapitalin e shoqërisë;
- b) shitblerjes;
- c) trashëgimisë;
- ç) dhurimit;
- d) çdo mënyre tjetër të parashikuar me ligj.

Në rastin e kalimit të kuotave me kontratë, kontrata duhet të bëhet me shkrim.



**Neni 10**  
**Zmadhimi dhe Zvogëlimi i Kapitalit Themeltar**

Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve me vendim, mund të zmadhojë kapitalin themeltar të shoqërisë duke rritur kuoten e ortakut ekzistues në shumën e përcaktuar në vendimin përkatës. Zmadhimi i kapitalit me qëllim pranimin e ortakëve të rinj në shoqëri, miratohet nga ana e asamblesë së përgjithshme të ortakëve të shoqërisë sipas nenit 81 pika 3 të Ligjit 9901.

Shoqëria mund të vendosë zvogëlimin e kapitalit themeltar të shoqërisë me vendimin e asamblesë së përgjithshme të ortakëve të shoqërisë sipas nenit 81 pika 3 të Ligjit 9901.

**Neni 11**  
**Blerja e Kuotave të Veta**

Shoqëria mund të blejë kuotat e veta dhe të kryejë pagesa për blerjen e tyre, jo nga fitimet e shoqërisë që do t'u shpërndahen ortakëve apo emetimi i kuotave të reja vetëm nëse shoqëria përmbush kushtet për shpërndarjen e fitimeve sipas nenit 77 të Ligjit dhe Administratori lëshon një certifikatë të aftësisë paguese të parashikuar nga ky nen. Në rast se blerja e kuotave të veta nuk është në përputhje me kushtet e nenit 77 të Ligjit, paditë mbi përgjegjësinë e shoqërisë mund të ngrihen në pajtim me parashikimet e nenit 78 dhe 79 të Ligjit "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare".

**Neni 12**  
**Kalimi i Fitimeve në Kapitalin Themeltar**

Asambleja e përgjithshme e ortakëve mund të vendosë të kalojë në kapitalin themeltar të shoqërisë fitimet e pashpërndara të cilat nuk do të përdoren për të paguar dividendë preferencialë apo shuma të tjera të parashikuara për rezervat e kapitalit të shoqërisë.

**Neni 13**  
**Shpërndarja e fitimit**

Ortaku ka të drejtë të marrë pjesën e fitimit të deklaruar në pasqyrat financiare të shoqërisë.

Shoqëria mund t'u shpërndajë fitime ortakut, vetëm nëse pas pagimit të dividendit:

- a) aktivet e shoqërisë mbulojnë tërësisht detyrimet e saj;
- b) shoqëria ka aktive likuide të mjaftueshme për të shlyer detyrimet që bëhen të kërkueshme brenda 12 muajve në vazhdim.

Administratori lëshon një certifikatë të aftësisë paguese, e cila konfirmon shprehimisht se shpërndarja e propozuar e dividendëve përmbush kërkesat e nenit 8/1, ndërsa kur gjendja e shoqërisë tregon se shpërndarja e propozuar e dividendëve nuk i përmbush këto kritere, administratori nuk mund ta lëshojë këtë certifikatë.



**Neni 14**  
**Ushtrimi i veprimtarisë**

Veprimtaria ekonomike e shoqërisë realizohet në bazë të dobisë ekonomike dhe pasqyrohet në bilancet e saj. Bilanci i aktivitetit të shoqërisë duhet të përfundojë dhe të jetë i miratuar brenda mars të vitit pasardhës. Bilancet e shoqërisë mund të bëhen nga vetë shoqëria ose nga ekspertë të caktuar prej saj.

Shoqëria krijon fondet e saj, përveç krijimit të fondeve të detyruara sipas ligjit, të cilat do të përdoren për zhvillimin e zgjerimin e veprimtarisë saj sipas rregullave në fuqi. Përbërja e këtyre fondeve caktohet me vendim të asamblese së përgjithshme të ortakut të shoqërisë sipas nenit 81, pika 3 të Ligjit 9901.

Shoqëria është pronare e mjeteve të saj financiare dhe i disponon vetë ato.

**KREU III**  
**ORGANET VENDIMARRËSE DHE DREJTUESE TË SHOQËRISË**

**Neni 15**  
**Organet drejtuese të shoqërisë**

Organet drejtuese të shoqërisë janë:  
Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve  
Administratori

**Neni 16**  
**Asambleja e Përgjithshme**

Asambleja e përgjithshme është organi i vetëm vendimarrës i shoqërisë.

Asambleja e përgjithshme është organi i vetëm vendimarrës i shoqërisë që ka për kompetencë ndryshimin e statutit të shoqërisë sipas përcaktimeve ligjore.

1. Asambleja e përgjithshme është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqërinë për çështjet e mëposhtme:

- a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
- b) ndryshimet e statutit;
- c) emërimin e shkarkimin e administratorëve;



- c) emërimin e shkarkimin e likuiduesve dhe të kspertëve kontabël të autorizuar;
- d) përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat "c" dhe "ç" të kësaj pike;
- dh) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- e) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- ë) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
- f) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- g) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- gj) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
- h) miratimin e rregullave procedural të mbledhjeve të asamblesë;
- i) çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.

Te drejtat dhe detyrimet e asamblese se pergjithshme ushtrohen nga ortaku i vetem konform nenit 81, pika 3 te Ligjit 9901.

#### **Neni 17 Marrja e vendimeve**

Te gjitha te drejtat dhe detyrimet e asamblese se pergjithshme ushtrohen nga ortaku i vetem. Te gjitha vendimet regjistrohen ne nje regjister te vendimeve. Duhet regjistruar ne vecanti, por pa u kufizuar ne to, vendimet per:

- Miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise;
- Shperndarjen e fitimeve dhe mbulimin e humbjeve;
- Investime;
- Vendimet per riorganizimin dhe prishjen e shoqerise;

#### **Neni 21 Emërimi i Administratorit**

Administrator i shoqërisë i emëruar nga mbledhja themeluese është:





**Ervis Myftari, i biri i Sadushit, i datëlindjes 08/05/1979, lindur dhe banues në Tiranë në adresën Rruga "Pjeter Bogdani, P.20/4", madhor dhe me zotësi të plotë për të vepruar, mbajtës i letërnjoftimit me Nr. Personal H90508052H.**

Afati i emërimit të administratorit është 5 vjet, me të drejtë ripërtëritjeje. Emërimi i administratorit fillon të prodhojë efekte pas regjistrimit të tij në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit.  
**Mandati i administratorit fillon me datë 02/11/2020 dhe mbaron me 01/11/2025.**

## **Neni 22 Kompetencat e Administratorit**

Administratori ka të drejtë si dhe detyrohet të:

- a) kryejë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;
- b) përfaqësojë shoqërinë tregtare;
- c) kujdeset për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
- ç) përgatisë dhe nënshkruajë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqet këto dokumente përpara asamblesë së përgjithshme për miratim;
- d) krijojë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
- dh) kryejë regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit;
- e) raportojë përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;
- ë) kryejë detyra të tjera të përcaktuara në ligj dhe në statut.

Paditë, që lidhen me shpërblimin e administratorit, në bazë të marrëdhënieve kontraktore me shoqërinë, rregullohen sipas dispozitave ligjore në fuqi.

## **Neni 23 Përfaqësimi**

Kufizimet e tagrave të përfaqësimit të administratorit i kundrejtohen palëve të treta, në përputhje me dispozitat e nenit 12 të Ligjit 9901.

Tagrat e përfaqësimit të administratorit dhe çdo ndryshim i tyre njoftohen për regjistrim pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit.



**Neni 25**  
**Shpërblimi dhe Përfitimet e tjera te Administratorit**

Administratori shpërblehet në bazë të Vendimit të marre nga Asambleja e Përgjithshme në përputhje me parashikimet e Nenit 97 të Ligjit "Per tregtarët dhe shoqëritë tregtare".

**Neni 26**  
**Kufizimet e Administratorit**

Administratori i shoqërisë, në ushtrimin e veprimtarisë së tij mban parasysh kufizimet që rrjedhin nga neni 13 i Ligjit Nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" Ai në asnjë rast nuk lejohet të lidhë kontrata huaje dhe garancie me shoqërinë. Kontratat e tjera të lidhura midis këtij personi dhe shoqërisë regjistrohen në një procesverbal, i cili bëhet në zyrën qendrore të shoqërisë.

Në rastet kur ai vepron në kundërshtim me parashikimet e nenit 13 dhe nenit 14/5 të statutit është vetë subjekt i dënimeve të parashikuara në nenin 13, pika 7 e ligjit Nr.9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", si dhe përgjigjet vetë në mënyrë solidare e shoqërinë me të gjithë pasurinë tij sipas parashikimeve të nenit 16 të Ligjit Nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare".

**Neni 27**  
**Përgjegjësia e Administratorit**

Administratori është përgjegjës individualisht ndaj shoqërisë për çdo veprim ose mos veprim, që lidhet në mënyrë të arsyeshme me qëllimet e shoqërisë tregtare, me përjashtim të rasteve kur, në bazë të hetimit dhe vlerësimit të informacioneve përkatëse, veprimi ose mos veprimi është kryer në mirëbesim.

**Neni 28**  
**Marrëdhëniet e punësimit në shoqëri**

Marrëdhëniet e punës me punonjësit që do të punësohen pranë shoqërisë rregullohen me kontratën e punës individuale që do të lidhet me secilin prej tyre.



## **KREU IV VITI FINANCIAR- EKSPERTËT**

### **Neni 29**

Viti financiar i shoqërisë fillon me datë 1 Janar të cdo viti dhe mbaron me datë 31 Dhjetor të cdo viti.

### **Neni 30 Ekspertët**

Eksperti ka për detyrë të kontrollojë të gjithë dokumentacionin e veprimtarisë ekonomiko tregtare të shoqërisë, atë gjithë vjetor dhe atë të në lidhje me kontrollet periodike të ushtruara prej tij për rastet kur ai është ngarkuar me një gjë të tillë nga ana e asamblese se pergjithshme te ortakeve te shoqërisë.

Në përfundim të kontrollit eksperti kontabël i certifikuar paraqet me shkrim raportin për nxjerrjen e rezultatit financiar të bilancit vjetor, si dhe për atë të kontrolleve periodike të kryera prej tij, të cilat është i detyruar t'i dprëzjë në kohë për tu shqyrtuar nga ana e asamblese se pergjithshme te ortakeve të shoqërisë.

## **KREU V**

### **PRISHJA LIKUIDIMI**

### **Neni 31**

#### **Prishja dhe likuidimi**

Shoqëria "PHOENIX GROUP LIMITED" shpk priset ne rastet e meposhtme:

- a) kur mbaron kohëzgjatja e parashikuar në themelimin e saj;
- b) me vendim të asamblese se pergjithshme
- c) me hapjen e procedurave të falimentimit;
- ç) nëse nuk ka kryer veprimtari tregtare për dy vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi i veprimtarisë në përputhje me pikën 3 të nenit 43 të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Biznesit";
- d) me vendim të gjykatës.

Prishja e shoqërisë tregtare ka si pasojë hapjen e procedurave të likuidimit në gjendjen e aftësisë paguese, me përjashtim të rasteve kur është nisur një procedurë falimentimi. Rregullat për procedurën e zakonshme të likuidimit në gjendjen e aftësisë paguese jane Nenet 191 deri në 203 të Ligjit 9901.



Shoqëria likuidohet me procedurë të thjeshtëzuar, në përputhje me nenet 204 dhe 205 të Ligjit 9901.

**Neni 32**  
**Shndërimi i shoqërisë**

Asambleja e përgjithshme, ka të drejtë që me vendim të vendosë për shndërrimin, transformimin e shoqërisë në ndonjë formë tjetër të shoqërive tregtare, duke zbatuar rregullat në fuqi.

**Neni 33**  
**Riorganizimi shoqërisë**

Shoqëria mund të ndahet të bashkohet me vendim të asamblese se përgjithshme të ortakëve. Ky proces do të bëhet në përputhje me rregullat e parashikuara në Pjesën IX të Ligjit Nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare".

**Neni 34**  
**Baza ligjore**

Shoqëria do të ushtrojë veprimtarinë e saj në përputhje me këtë statut dhe legjislacionin në fuqi.

Për atë që nuk parashikohet në këtë Statut do të zbatohen parashikimet e ligjit Nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", Kodit Civil dhe të çdo ligji tjetër në fuqi në Republikën e Shqipërisë.

---

**ORTAKU**

**Ervis Myftari**

